



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2021:004200
Datë: 23.04.2024
Numri i dokumentit: 05607013

K.DH.SH.II.nr.1610/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Ramush Bardiqi, anëtarë të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Aldex Qeramika” ShPK me seli në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson “RPHS” L.L.C me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK), në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.63/21, të datës 14.06.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë ankesa e paditësit “Aldex Qeramika” ShPK me seli në Prishtinë, si e pa afatshme.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative Divizioni Fiskal A.nr.63/21, të datës 14.06.2022, është refuzuar kërkesëpadia e paditësit “Aldex Qeramika” ShPK me seli në Prishtinë, në tërësi si e pabazuar dhe ka mbetur në fuqi Aktvendimi 01.3.2.2/14597 i datës 07.12.2020, i Doganës së Kosovës me seli në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka ushtruar ankesë paditësi “Aldex Qeramika” ShPK me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontentsimore, konstatimit ta gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozimin që të aprovet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, të anulohet në tërësi si i kundërligjshëm aktgjykimi i atakuar dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Dhoma e shkallës së dytë e kësaj gjykate shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.H të Ligjit

04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222, gjeti se:

Ankesa është pa afatshme.

Kolegji i kësaj gjykate me shikimin në fletë kthesë ka vërtetuar se përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka pranuar aktgjykimin A.nr.63/21, të datës 14.06.2022, me datë 06.07.2022, ndërsa ankesën ndaj këtij aktgjykimi e ka dorëzuar në postë me datën 20.09.2022, e cila shihet nga vula e pranimit të Postës, ndërsa data e pranimit në gjykatë është 22.09.2022.

Kolegji i kësaj gjykate duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes pasi që në dispozitën e nenit 81.H par.5 të Ligjit 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat 03/L-222 përcaktohet se: *“Vendimi i Gjykatës Themelore mund të kundërshtohet përmes gjykatës kompetente brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve të komunikimit të tij zyrtar tek palët.”*, atëherë rezulton që ankesa është dorëzuar pas skadimit të afatit prej 60 ditësh, për faktin se afati fillon të llogaritet nga data 07.07.2022, dhe kur llogariten 60 ditë, atëherë dita e fundit për parashtrimin e ankesës ka qenë data 04.09.2022. Prandaj, meqë ankesa është paraqitur me datën 20.09.2022, atëherë rezulton se ankesa është paraqitur me vonesë prej 16 ditëve.

Në bazë të të cekurave dhe duke marrë për bazë se afati për ankesë është afat prekluziv, Kolegji i kësaj gjykate, në kuptim të dispozitës së nenit 209 par.1, pika (a) të LPK-së, të aplikueshëm në bazë të nenit 63 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVES
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1610/22, me datë 23.04.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova